



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 59, Datë 29.10.2007

**“PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E MENCËS NË QËNDRËN SOCIALE  
“TË QËNDROJMË SË BASHKU” SI DHE PËR MIRATIMIN E NJË  
NDRYSHIMI NË STRUKTURË”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore “, neni 10, pika 3 /II (gërma “c”), neni 32, gërma “ç”, Ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005 ‘Për Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore”, Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, V.K.M.Nr.551, datë 07.11.2002 “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njërive të qeverisjes vendore, për efekt page, për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, pika 14, Udhëzimit të M.P.C.S.SH.B. Nr. 303, datë 13.02.2007, “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare të përkujdesit shoqëror”, pika 2, gërma “a”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 62, datë 10.11.2006, “Për krijimin e Qendrave Sociale”, “Qendër komunitare multidisiplinore për fëmijët dhe familjet në nevojë”, qendrën “Të qëndrojmë se bashku” dhe qendrën “Qendër komunitare për të moshuarit”, miratimin e strukturës organizative dhe financimin e kontributit të Bashkisë Tiranë” dhe V.K.B. Nr. 23, date 30.04.2007 “Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2006 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I:**

**1.**Të miratojë krijimin dhe funksionimin e mencës në qendrën sociale “Të qëndrojmë së bashku”.

**2.** Në mbështetje të pikës 1 të këtij vendimi, kostoja e ushqimit për person do të jetë jo më shumë se 120 leke (njëqind e njëzet leke) dhe do të sigurohet në mënyrë të gatshme.

**3.** Të miratohet niveli i pagës për punonjësin e marrës së qendrës sociale “Të qëndrojmë së bashku” sipas lidhjes 9/1 bashkëlidhur.

**4.** Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i miratuar për qendrën sociale “Të qëndrojmë së bashku” për vitin 2007.

**5.** Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, dhe Qendra “Të qëndrojmë së bashku”.

**6.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit.

**Sokol DERVISHAJ**

**K R Y E T A R**